

L I G J
Nr.9003, datë 13.2.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR PËR PROJEKTIN “FURNIZIMI ME UJË I ZONAVE FSHATARE TË KAVAJËS II – ZONA E MANSKURISË””

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar për projektin “Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II – Zona e Manskurisë””, me një hua prej 1 553 875,64 Euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3717, datë 28.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR

(Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II – zona e Manskurisë)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;
duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;
të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje,
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,
duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare gjermano-shqiptare të datës 5 dhjetor 2001, ranë dakord si vijon :

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt am Main, shumat e mëposhtme:

1) një hua me vlefë prej deri në eur 2.045.167,52 (dy milion e dyzet e pesë mijë njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë 52/100 euro) për projektin “Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II – zona e Manskurisë;

2) një shumë financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e

projektit të përmendur në pikën 1 me vlefë prej deri në eur 1.533.875,64 (një milion e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë 64/100 euro) për projektin “Furnizimi me ujë i zonave fshatare të Kavajës II - masa shoqëruese”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur dhe pasi u konfirmua se ai plotëson kushtet e veçanta për mbështetje me anë të një shume financimi.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, projektet e përmendura në paragrafin 1 mund të zëvendësohen me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi, për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi, për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1, pika 2 dhe paragrafit 3 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen ndërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, si dhe marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1, pikat 1 dhe 2 do të zhvleftësohen, në rast se kontrata përkatëse për huanë ose për financimin nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Afati për premtimin e shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1, pika 1 mbaron për shumën e pjesshme prej eur 766.937,82 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë 82/100 euro) më datë 31 dhjetor 2006, për shumën e pjesshme prej eur 1.278.229,70 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë 70/100 euro), më datë 31 dhjetor 2008. Afati për premtimin e shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 pika 2 mbaron, më datë 31 dhjetor 2005.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është huamarrëse, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratave që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo nuk është marrëse e shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale për shlyerje, të cilat mund të lindin në bazë të kontratave për financim që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huasë; nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për

hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 11 dhjetor në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.